



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

LIDHJA Nr. 1. FUNKSIONET DHE DETYRAT E AUTORITETIT PUBLIK

MISIONI I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

Misioni i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, është gjykimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve penale dhe civile, në përputhje me normat juridike në fuqi dhe të bazuara në fakte të provuara, duke dhënë vendime të drejta, në frymën e Kushtetutës dhe Ligjeve.

Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, udhëhiqet nga parimet e Shtetit të së Drejtës, respektimit të të drejtave të njeriut dhe dinjitetit njerëzor, barazisë përpara ligjit, pavarësisë së organeve gjyqësore dhe transparencës.

Zbatimi rigoroz i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të ligjeve dhe në tërësi korpusit juridik të detyrueshëm në Shqipëri, garanton misionin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për të mbrojtur dinjitetin dhe liritë themelore të njeriut, në përputhje me kërkesat dhe në funksion të zhvillimit të një shoqërie demokratike që aspiron integrimin Europian.

Stafi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, synon të realizojë me cilësi dhe efektivitet ofrimin e shërbimeve gjyqësore për qytetarët brenda afateve dhe në përputhje me normat ligjore.

Menaxhimi efektiv dhe cilësor i fondeve buxhetore, me frymën e bashkëveprimit profesional dhe të përgjegjshëm të stafit të saj, pasqyron misionin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në përmbushjen e pritshmërive të qytetarëve për marrjen e shërbimeve dhe aksesit në informacion për publikun e gjerë, në kohë dhe me cilësi.

OBJEKTIVAT KRYESORË

- Garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të palëve në proceset gjyqësore.
- Sundimin e së drejtës dhe ligjit në gjykimin e mosmarrëveshjeve.
- Gjykimin e çështjeve brenda afateve të arsyeshme dhe të përcaktuara në ligj.
- Pasqyrimin e standarteve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
- Rritjen dhe forcimin e besimit të qytetarëve dhe opinionit publik në drejtësinë e vendimeve gjyqësore.
- Përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve ndaj publikut, duke aplikuar progresivisht arritjet teknologjike dhe burimet njerëzore, me kapacitete profesionale të larta.
- Krijimin e një mjedisi profesional, dinamik dhe ndërveprues ndërmjet anëtarëve të administratës gjyqësore, duke reflektuar integritet, përgjegjshmëri dhe kulturën e të punuarit në grup.

-

KOMPETENCAT TOKËSORE

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, shqyrton çështje që përfshihen në kompetencën territoriale të Qarkut të Elbasanit, në fushën e së drejtës civile dhe penale. Veprimtaria e Gjykatës bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Ligj nr. 98/2016 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe në ligje e akte të tjera juridike, në fuqi, që normojnë veprimtarinë e Gjykatës, Gjyqtarëve, administratës së Gjykatave, shërbimeve gjyqësore, menaxhimin e çështjeve gjyqësore dhe marrëdhënien e Gjykatësme degët e tjera të pushtetit shtetëror, publikun dhe median.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ushtron kompetencën e saj lëndore në territorin e Qarkut Elbasan, që mbulon përkatësisht bashkitë e mëposhtme: Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Cërrik, Belsh dhe Përrenjas. Vendndodhja e Gjykatës është në qytetin e Elbasanit me adresë : Lagjja ‘5 Maji’ , Rruga ‘Koço Brisku’, Elbasan, Shqipëri.

INFRASTRUKTURA

Ndërtesa ku ndodhet Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është ndërtuar në vitin 2017 dhe përmban 20 zyra gjyqtarësh, 10 zyra të punonjësve administrativë, 10 salla gjyqi (2 penale dhe 8 civile).

Gjykata nuk e ndan hapësirën e ndërtesës me ndonjë institucion tjetër. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ndodhet në një ndërtesë bashkëngjitur asaj të Gjykatës, por të ndarë prej saj.

Gjykata i përmbush standardet e projektimit që lidhen me sigurinë dhe/ose shmangien e komunikimit ex-parte (ndodhen hyrje dhe dalje të dedikuara për personelin e Gjykatës, palët dhe/ose të paraburgosurit). Hapësira e shërbimit ndaj publikut është e krijuar sipas standardeve të kërkuara.

BURGJET/STRUKTURAT E TJERA NËN KOMPETENCËN TOKËSORE TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

Aktualisht nën kompetencën tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan janë 3 Institucione të Ekzekutimit të Vendimeve Penale:

- Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan, me një distancë të përlogaritur prej 6 km nga ndërtesa e Gjykatës.
- Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin, me një distancë të përlogaritur prej 30 km nga ndërtesa e Gjykatës.
- Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Lushnje me një distancë të përlogaritur prej 46 km nga ndërtesa e Gjykatës.

STRUKTURA E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Nenin 7 i ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” përcakton:

Neni 7

“Kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë

1. Në përputhje me programin e transpa-rencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit:

a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik; b) tekstet e plota:

i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) të ligjeve;

iii) të akteve nënligjore;

iv) të kodeve të sjelljes;

v) të çdo dokumenti politikash;

vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë;

c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;

ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinators për të drejtën e informimit;

d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;

dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;

ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë:

i) listën e kontratave të lidhura;

ii) shumën e kontraktuar;

iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;

iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme; f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet

për cilësinë e shërbimit;

g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;

h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji;

j) një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato;

k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;

l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.

2. Autoriteti publik, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje dixhitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë.

3. Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga autoritetet publike.”,

Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ndërton dhe rrit transparencën në punën e saj institucionale, nën garancinë e Ligj për të Drejtën e Informimit.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje **me pikën 2 të nenit 5** të Ligj për të Drejtën e Informimiti cili përcakton:

Neni 5

“Rishikimi i programit të transparencës 1. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij. 2. Afatet për rishikimin e programit të transparencës mund të ndryshojnë në varësi të natyrës së çdo autoriteti publik, por, në asnjë rast, nuk mund të jenë më të gjata se 5 vjet.”

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të realizojë objektivat e përcaktuara në Ligj për të Drejtën e Informimit, transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nëpërmjet pasqyrimin të detajuar të tij në faqen zyrtare si www.gjykataelbasan.gov.al dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afate kohorë për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron rubrikat ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemën e Programit të Transparencës.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm dhe të aksesueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj i cili përcakton:

“Neni 23 1. E drejta e informimit është e garantuar. 2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione 10 shtetërore. 3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.”

2. Informacioni që rrjedh nga veprimtaria e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të

Përgjithshëm Elbasan, publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për sistemin gjyqësor.

3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan përkatësisht: - Ligj Nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë (Ndryshuar me Ligjin Nr.114/2013, Datë 11.4.2013,
4. Rregulloren “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Gjyqësore”, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Drejtësisë Nr. 1830, datë 03.04.2001,
5. Urdhërin “Për miratimin e Rregullores teknike për përdorimin e pajisjeve elektronike” të përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore (ICMIS), përdorimit të sistemit audiorekorder (R.D.A), përdorimit të kalendarit elektronik (P.A.K.S)
6. Informacioni është përshtatur në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme.
7. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (këtej e tutje KDIMDP).
8. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
9. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
 - i plotë;
 - i saktë;
 - i përditësuar;
 - i thjeshtë në konsultim;
 - i kuptueshëm;
 - lehtësisht i aksesueshëm;
 - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESE

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me këtë program transparence Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, vendos në dispozicion të publikuara në faqen e internetit ww.gjykataelbasan.gov.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të autoritetit publik;

- Tekstet e plota, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinаторit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitete kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;
- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr.9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politikatë ndryshme;
- Informacion për shërbimet që Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet

ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në ç'farëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

- Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje dixhitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti/ Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
		Skema e			
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan	Neni 7/1/a/d	strukturës organizative. Struktura e pagave. Tabelë e funksioneve dhe e detyrave. CV-të e funksionarëve të lartë. Rregullore e brendshme Kodi i etikës Ligji Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; Ligji Nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”; Ligji Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” Vendime të KLGJ-së Vendime të Gjykatës Kushtetuese Akte ligjore/nënligjore	Menjëherë pas botimit në fletore zyrtare, Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari.	Në faqen zyrtarenë Rubrikën Programi i transparencës- Njoftime të tjera	Koordinatori, Kryetari i Gjykatës ose nëpunësi deleguar prej tij dhe Këshilli i Gjykatës.
Akte ndërkombëtare ligje; akte nën ligjore; dokument politikash; dokument tjetër.	Neni 7/1/b	Ligje/Akte nënligjore/Rregullore	Pas hyrjes në fuqi	Në faqen zyrtarenë Rubrikën “Programi i <u>transparencës</u> ” - Rregullore	Administrata e Gjykatës Sektori i Shërbimeve

Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitim të kërkesave për informim, sidhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Neni 7/1/c/g	Format kërkesë Format Kthim përgjigje Format Refuzim i kërkesës Format Zgjatje e afatit të përgjigjes etj Adresë postare: Lagjja 5 Maji, Rruga Koco Brisku Posta elektronike Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun dhe Median Manjola.Kume @gjkata.gov.al Adresë web: www.gjkataelbasan.gov.al	Pas miratimit të Programit të transparencës. Menjëherë, në rast ndryshimesh	Në faqen zyrtare në rubrikën “Programi i transparencës”. E drejta për tu informuar dhe ankuar	Administrata e Gjykatës Sektori i Shërbimeve
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinitorit për të drejtën e informimit.	Neni 7/1/ç	Adresë postare: Lagjja 5 Maji, Rruga Koco Brisku Posta elektronike e koordinitorit Adresë web: www.gjkataelbasan.gov.al Orari: e Hënë - e Premte ora 08:00 - 16:00	Pas miratimit të urdhrit caktimit të Koordinitorit	Në faqen e zyrtare në rubrikën “Programi i transparencës” rubrika E drejta për tu informuar dhe ankuar	Drejtuuesi i Gjykatës
Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.	Neni 7/1/d	Referuar Ligjit Nr. 9877 datë 18.02.2008 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (Ndryshuar me ligjin Nr. 114/2013 datë 11.04.2013) Vendime të KLD-së Vendime të Gjykatës Kushtetuese Akte ligjore/nënligjore	Pas hyrjes në fuqi	Në faqen zyrtare në Rubrikën “Programi i transparencës”	Stafi Drejtues i Gjykatës
Mekanizmat monitorues; raporte audit; dokumentet me tregues performance	Neni 7/1/dh	Analiza Vjetore e Punës	Përditësohet periodikisht	Në rubrikën “Analiza Vjetore e Punës”	Stafi Drejtues i Gjykatës

Buxheti	Neni 7/1/e	Parashikimet e nenit 57 të ligjit 8737/2001 i ndryshuar. Ligji për buxhetin dhe akte nënligjore në zbatim të tij Raporte për monitorimin e performancës	Pas hyrjes në fuqi	Në faqen zyrtare të Zyrës së Administrimit të Buxhetit zyqësor	Zyra e Buxhetit
Informacion për procedurat e prokurimit.	Neni 7/1/ë	Regjistri	Menjëherë pas dërgimit në Agjencinë e Prokurimit Publik.	Në faqen zyrtare të Agjencinë e Prokurimit Publik.	Zyra e Buxhetit
Shërbimet e autoritetit për publikun.	Neni 7/1/f	Vërtetime, Ankime, Rekurse, Kopje aktesh/dokumentesh Kërkesë padi, Vendime etj.	Përditësohet	Në faqen zyrtare në rubrikën ”	Kryesekretaria (Kancelaria) dhe Punonjësi i Informatikës (IT) i Punonjësi i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median/Koordinatori
Mbajtja e dokumentacionit nga Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.	Neni 7/1/h	Ruajtja e dokumentacionit në sistemin arkivor të insitucionit bëhet në përputhje me kuadrin ligjor për arkivat në Republikën e Shqipërisë.	Përditësohet	Në faqen në rubrikën	Arkivi Protokol li
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr.119/2014.	Neni 7/1/i	Tabelë	Pas miratimit të programit të transparencës.	Në faqen zyrtare në rubrikën “Programi i transparencës” Me kufizime të identitetit të ankuesit.	Punonjësi i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median/Koordinatori Koordinator për të drejtën e informimit
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni	Datat e gjykimeve, Vendime gjyqësore, etj..	Përditësohen	Në faqen zyrtare në rubrikën ”	Administrata e Gjykatës
Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/l	Njoftime me afishim publik, Njoftime etj..	Përditësohen Periodikisht	Në faqen zyrtare në rubrikën	Administrata e Gjykatës

PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar nga Gjkata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ky program vendoset në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.gjkataelbasan.gov.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një rubrikë të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit. Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.